

MANUAL

Trajnimi i trajnerëve

Të mësuarit joformal dhe metodat ndërvepruese në punën me të rinjtë



Përpilues:
Qendra AMAD

Ekipi i lehtësimit të grafikut dhe Dizajni:
Qendra AMAD

© Qendra AMAD®

Tiranë, Shkurt 2023

“Ky modul u realizua në kuadër të projektit “FuqiZona: Rritje kapacitetesh rinore”, me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, AKR dhe Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, MSHRF. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e AKR dhe MSHRF.”

Tabela e përmbajtjes

NË VEND TË HYRJES	6
PËRMBLEDHJE	7
Pjesa 1: Koncepte të përgjithshme	7
1.1 Çfarë është puna për të rinjtë?	7
1.2 Karakteristikat e punës rinore.....	9
1.3 Qasjet ndaj punës rinore.....	9
1.4 Puna rinore: etika.....	12
1.5 Edukimi joformal – Themel në punën rinore	13
1.6 Kompetencat e punës rinore.....	15
Pjesa 2: Koncepte bazë	18
2.1 Teoria e inteligjencës së shumëfishtë	18
2.2 Cikli i trajnimit: Procesi dhe facilituesi/ lehtësuesi	19
2.2.1 Përvojë konkrete	19
2.2.2 Vëzhgimi dhe reagimi	20
2.2.3 Reflektimi.....	20
2.2.4 Formimi i koncepteve dhe përfundimeve abstrakte.....	21
2.2.5 Testimi i aplikimit të konceptit në një situatë të re	22
2.3 Kategorizimi sipas stileve të të mësuarit.....	23
2.3.1 Reflektuesi	23
2.3.2 Teoricieni	23
2.3.3 Pragmatisti.....	24
2.3.4 Aktivisti.....	24
2.4 Motivimi.....	25
2.5 Kompetencat kyçe e të mësuarit gjatë gjithë jetës	26
2.6 Trajnimi, mentorimi, udhëheqja dhe lehtësimi	27
2.6.1 Trajnimi	28
2.6.2 Lehtësimi (facilitimi)	29
2.6.3 Udhëheqja (Coaching).....	31

2.6.4 Mentorimi	32
2.7 Inteligjenca emocionale	33
2.8 Këshillimi rinor	34
2.9 Orientimi në karrierë.....	36
Pjesa 3: Aftësi praktike	37
3.1 Vlerësimi i nevojave të të rinjve	37
3.2 Taksonomia e objektivave të të mësuarit.....	38
3.3 Njihu me grupin/individin	39
ANEKS: SHEMBUJ PUNËTORISH	40
TEMA: Fuqizimi, bashkëpunimi dhe krijimi i ekipit, ndërtimi i marrëdhënieve me të rinjtë, lojëra argëtuese	40
"Loja me karrige"	41
"Loja e emrave"	42
"Kulla me gota"	42
Tema 2: Puna, Diskriminimi dhe Intoleranca	43

NË VEND TË HYRJES

Ky manual përmban një informacioni të konsiderueshëm udhërrëfyes, bazuar në përvojën afatgjatë të autorëve në fushën e të mësuarit joformal dhe të arsimit ndërveprues të të rinjve dhe të rriturve. Gjatë përpilimit të tij u përdorën informacione të shumta në lidhje me temën nga burime të ndryshme - studime, raporte dhe botime shkencore.

Mungesa e një skeme trajnimi adekuat për punonjësit rinorë çon në përdorimin joefikas të kapaciteteve të profesionistëve që punojnë në këtë fushë. Ky doracak plotëson një nga boshllëqet në sektorin e punës me të rinjtë, përkatësisht nevojën për metodologji për trajnimin e trajnerëve të aftë për të trajnuar punonjësit rinorë, të rriturit dhe të rinjtë. Duke kombinuar përvojën praktike me konceptet teorike rreth kësaj fushe të ekspertit përpilues dhe të ekipit përgatitës në formatim dhe design, ky manual u krijua për të sjellë një sërë temash dhe instrumentesh rreth të mësuarit joformal dhe rritjes së kapaciteteve rinore, për zhvillimin e tyre social dhe profesional. Gjithashtu, jemi përpjekur të mos përsërisim tema që janë të njohura dhe të disponueshme në fushën e të mësuarit joformal në punën me të rinjtë.

Krijimi i manualit "Trajnimi i trajnerëve – Të mësuarit joformal dhe metodat ndërvepruese në punën me të rinjtë" paraqet një produkt trajnimi që vjen në shërbim të përfituesve të ndryshëm. Ky manual mund të përdoret nga organizata të shoqërisë civile, institucione, grupe joformale etj., që kanë në fokus të veprimtarisë së tyre të rinjtë dhe punonjësit rinorë, të cilët përmes edukimit joformal synojnë rritjen e kapaciteteve vetjake, si edhe të përfituesve të targetuar.



PËRMBLEDHJE

Manuali është gjithëpërfshirës fushën e zhvillimit të kompetencave tek të rinjtë, gjë që do të rrisë konkurrencën e tyre në tregun e punës dhe përfshirjen dhe pjesëmarrjen e tyre sociale. Modeli synon të paraqesë mjete për të arritur një përmirësim real në cilësinë dhe standardet e punës së të rinjve, aktivizmit rinor në komunitet, si dhe në këtë mënyrë të orientojë zgjidhje në sfidat me të cilat përballen të rinjtë. Trajnimi cilësor i punonjësve rinorë në ofrimin e shërbimeve adekuate për të rinjtë është lidhja kryesore midis sistemit arsimor dhe punës së të rinjve. Rezultati i ndërthurjes së potencialit të arsimit formal dhe joformal është mundësia për të zhvilluar të rinj, duke shpalosur potencialin e tyre të plotë, të cilët krijojnë shoqëri më të drejta. Manuali synon të jetë sa më i përshtatshëm për njerëzit me nivele të ndryshme eksperience në fushën e edukimit joformal. Nga ana tjetër nuk jemi të fokusuar në mbledhjen dhe publikimin e aktiviteteve, lojërave dhe mjeteve, sepse besojmë se ka një numër të mjaftueshëm koleksionesh të ngjashme të botuara, si dhe biblioteka online.

Një nga qëllimet kryesore të këtij manuali është të pasurojë mësimin joformal me aplikimin e qasjeve moderne të të nxëniet për përmirësimin e rezultateve. Procesi i të mësuarit për trajnerët, punonjësit rinorë dhe të rinjtë bazohet në parimet e të mësuarit joformal, si edhe pasurohet me koncepte të tjera nga mësimdhënia ndërvepruese dhe pedagogjia moderne. Koncepte të tilla të përfshira në proces janë:

- *Inteligjenca të shumëfishta;*
- *Të mësuarit socio-konjitiv;*
- *Të nxëniet eksperimental;*
- *Stilet e të nxëniet;*
- *Fazat e zhvillimit;*
- *Vetëefikasiteti etj.*

Të gjitha këto koncepte mbështetëse janë përfshirë në këtë manual "Trajnimi i trajnerëve – Përdorimi i të mësuarit joformal dhe metodave ndërvepruese në punën me të rinjtë", të cilat mund të përshtaten dhe zbatohen në nivele të ndryshme (institucione të qeverisjes vendore, shkolla, komunitet, OJQ, bashki, institucione me shtrirje veprimtarie në rrafsh kombëtar etj.). Kjo lejon që rezultatet e manualit të përsëriten dhe të përdoren si një mjet i vërtetë për integrimin e punës së të rinjve dhe mësimin joformal në nivele të ndryshme për të trajtuar problemet e të rinjve.

Tematikat e manualit janë ndarë në tri pjesë kryesore:

Pjesa 1: Konceptet bazë – ku trajtojmë parimet e përgjithshme lidhur me punën me të rinjtë, edukimin joformal dhe etikën e trajnerit.

Pjesa 2: Kuadri teorik – i cili përshkruan konceptet themelore teorike që lidhen me të nxëniet, metodat ndërvepruese dhe zhvillimin e kompetencave.

Pjesa 3: Aftësitë praktike – me mjete dhe metoda specifike për aplikimin e teorive dhe koncepteve gjatë hartimit dhe realizimit të programeve të trajnimit.

Pjesa 1: Koncepte të përgjithshme

Termi "punë rinore" mbulon një fushë të gjerë aktiviteteve të natyrës sociale, kulturore, arsimore ose politike nga, me dhe për të rinjtë. Gjithnjë e më shumë, aktivitete të tilla përfshijnë edhe sportin dhe shërbimet për të rinjtë. Siç edhe është nënvizuar nga Këshilli i Evropës¹, puna për të rinjtë i përket fushës së edukimit "jashtë shkollës", si dhe aktiviteteve specifike të kohës së lirë të menaxhuara nga punonjës rinorë profesionistë ose vullnetarë dhe drejtues rinorë. Puna me të rinjtë organizohet në mënyra të ndryshme (nga organizata të udhëhequra nga të rinjtë, organizata për të rinj, grupe joformale ose përmes shërbimeve rinore dhe autoriteteve publike). Shpërndahe në forma dhe mjedise të ndryshme (p.sh. akses i hapur, i bazuar në grup, i bazuar në program, i shtrirë dhe i shkëputur) dhe i jepet formë në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe evropian.

Ashtu si vendoset theksi edhe në Strategjinë Kombëtare për Rininë (2022-2029), "në procesin e krijimit të një ekonomie të fortë të bazuar në modernizim, produktivitet dhe konkurrueshmëri, Shqipëria shihet si qendër rajonale për sipërmarrjet e reja në ekonominë digjitale duke siguruar punë dinjitoze për të rinjtë për të realizuar kështu një kthesë cilësore në punësimin rinor."²

1.1 Çfarë është puna për të rinjtë?

Sipas përcaktimit në platformën online të Këshillit të Evropës³, Puna me të rinjtë zakonisht kuptohet si një mjet për zhvillimin personal, integrimin social dhe qytetarinë aktive të të rinjve. Ky term përdoret si një 'fjalë kyçe' për të gjitha llojet e aktiviteteve me, për dhe nga të rinjtë e natyrës sociale, kulturore, arsimore ose politike, referuar fushës së edukimit 'jashtë shkollës', më së shpeshti i referuar të mësuarit joformal. Objektivi kryesor i punës së të rinjve është krijimi i mundësive për të rinjtë që të ndërtojnë të ardhmen e tyre.

Për çfarë shërben puna rinore?

JEP MUNDËSI
të rinjve të kryejnë gjërat që duan individualisht dhe së bashku

Sigurimi i mundësive për t'u **EMANCIPUAR** dhe fituar autonomi

Garantimi i mundësive të sigurta dhe të shëndetshme për të rinjtë, që t'i **SHIJOJNË** në kohën e lirë



FUQIZON
të rinjtë të ndryshojnë gjërat që ata mendojnë se duhen ndryshuar në rrethin e tyre apo në shoqëri

Ndihmon të rinjtë të **ANGAZHOHEN** në fuqi vendimmarrëse dhe politikash

Garantimi i mundësive të **EDUKIMIT** joformal relevant dhe përfshirës, që përmirëson kompetencat e të rinjve

¹ www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/educ/137150.pdf

² <https://riniafemijet.gov.al/wp-content/uploads/2023/03/Strategjia-Kombetare-e-Rinise-2022-2029-1.pdf>

³ <https://www.coe.int/en/web/youth-portfolio/youth-work-essentials>

1.2 Karakteristikat e punës rinore

Puna rinore zakonisht ka karakteristikat e mëposhtme:

- **Drejtuar nga vlera:** puna rinore përpiqet t'i shërbejë qëllimeve më të larta të përfshirjes dhe kohezionit social.
- **Me në qendër të rinjtë:** puna rinore u shërben nevojave dhe aspiratave kryesore të të rinjve, të identifikuar nga vetë të rinjtë.
- **Vullnetare:** puna rinore nuk është e detyrueshme dhe mbështetet në pjesëmarrjen vullnetare të të rinjve.
- **Zhvillimore:** puna rinore synon zhvillimin personal, social dhe etik të të rinjve.
- **Vetëreflektues dhe kritike:** puna rinore përpiqet të sigurohet se po bën më të mirën për të përmbushur misionin e saj.
- **Relacionale:** puna rinore kërkon komunikim autentik me të rinjtë dhe për të kontribuar në ruajtjen e komuniteteve të qëndrueshme.



1.3 Qasjet ndaj punës rinore

Natyra specifike e aktiviteteve të punës rinore nuk është domosdoshmërisht çelësi për të kuptuar se çfarë është puna me të rinjtë. Kështu për shembull, angazhimi i të rinjve në organizimin e një kampi veror sportiv dhe lojërash mund t'u shërbejë të njëjtave qëllime sikurse t'i drejtosh ata një klub rinor kinemaje gjatë një viti. Megjithatë, aktivitetet e punës për të rinjtë mund të grupohen në disa kategori, të tilla si:

- Rritja e ndërgjegjësimit dhe fushata;
- Informacion dhe këshillim;

- Zhvillimi ndërkombëtar dhe vullnetarizmi qytetar;
- Kurse dhe aktivitete të bazuara në kohën e lirë;
- Aktivitetet e projektit (të vetorganizuara);
- Punë në komunitet dhe punë në terren.

Këto aktivitete mund të realizohen në shumë fusha të ndryshme, duke filluar nga kultura dhe artet, zanatet, mjedisi, trashëgimia kulturore dhe historike, sporti, deri te aspekte të tilla si politika, qytetaria, të drejtat e njeriut dhe çështjet rreth shëndetit, sigurisë apo krimit.⁴

Për shkak të shumëllojshmërisë së faktorëve socio-ekonomikë që përcaktojnë kushtet e punës së të rinjve, ekzistojnë mënyra të ndryshme të punës me të rinjtë. Qasjet më të rëndësishme janë paraqitur më poshtë.

a) Puna e të rinjve në komunitet

Punonjësit e të rinjve në komunitet ofrojnë aktivitete të bazuara në komunitet për të rinjtë në një sërë mjedisesh në të gjithë komunitetet lokale, duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile, institucionet qeveritare etj.

b) Puna rinore me një vend bazë

Kryhet në ambiente të dedikuara, të cilat mund të përfshijnë ambiente si bar-kafe, ambiente sportive dhe qendra këshillimi. Shumica e klubeve të të rinjve i përkasin kësaj kategorie mjaft të gjerë. Vendi varet nga të rinjtë që zgjedhin të vijnë në qendër, por në disa raste mund të lidhet me punën e të rinjve në terren ose në shkollë.

c) Puna rinore e bazuar në besim

Kryhet nga baza e moralit fetar dhe mund të jetë me qëllim të ndarjes ose krijimit të pikëpamjeve fetare. Në shumë situata të bazuara në besim, axhenda kryesore ose qëllimi i punës për të rinjtë përputhet me qëllimet shpirtërore të fesë, ose me përparimin e perceptuar të një të riu drejt këtyre qëllimeve. Në Irlandën e Veriut, 64% e punës për të rinjtë bazohet në besim.

d) Punë rinore e shkëputur

Në formën e saj më të pastër, puna e shkëputur për të rinjtë është një formë e ofrimit të punës rinore në rrugë, e cila funksionon pa përdorimin e një qendre dhe zhvillohet aty ku të rinjtë "janë", si gjeografikisht ashtu edhe nga ana zhvillimore. Shpesh ngatërrohet me punën në terren, për shkak të parimeve të ngjashme (d.m.th. kontakti në rrugë me të rinjtë "të vështirë për t'u arritur"). Puna e shkëputur shihet si më shumë sesa përpjekje për të inkurajuar të rinjtë që të përdorin mjetet ekzistuese (që është përkufizimi i përdorur shpesh i punës në terren), funksionon si një metodë për të ofruar edukim joformal dhe social, si edhe ka të bëjë me adresimin e çfarëdo nevoje që i paraqitet ose perceptohet nga punonjësi rinor.

e) Puna e të rinjve në terren

⁴ Burimi: Puna me të rinjtë: vlera e punës së të rinjve në Bashkimin Evropian - https://ec.europa.eu/assets/eac/youth/library/study/youth-work-report_en.pdf

E ngjashme me punën e shkëputur rinore, kontakti është një formë e punës rinore që zhvillohet në territorin e të rinjve dhe është një metodë pune që mbështet dhe plotëson punën rinore të bazuar në qendra/projekte të reja dhe ekzistuese.

E përdorur kryesisht për të informuar të rinjtë për shërbimet që ekzistojnë në lokalitetin e tyre dhe për t'i inkurajuar ata të përdorin shërbime të tilla, kjo qasje mund të kërkojë gjithashtu të identifikojë, nëpërmjet konsultimit me të rinjtë, çdo boshllëk që ekziston në shërbimet që synojnë plotësimin e nevojave të tyre. Ndryshe nga puna rinore e shkëputur, kjo qasje shihet si një shtrirje për punën e bazuar në qendër. Kjo ndodh kur punonjësit që zakonisht zhvillojnë veprimtarinë në qendër dalin në rrugë me një axhendë të tyre, zakonisht për të inkurajuar të rinjtë të marrin pjesë në klubin e tyre.

f) Punë e bazuar në shkollë

Kjo formë e punës rinore kryhet në shkolla dhe ofrohet drejtpërdrejt për nxënësit, shpesh nga një organizatë jashtë shkollës. Mund të përfshijë mësim, asamble, klube pas shkollës, mentorim një me një etj. Mund të ketë një lidhje edhe me aktivitete të tjera rinore joshkollore.

g) Organizata rinore

Këto janë gurthemeli i punës rinore në shumë vende, me organizata të tilla dhe aktivitetet e tyre bazohen në përfshirjen dhe organizimin e vetë të rinjve. Ato mund të variojnë nga entiteti lokal deri te organizatat rinore pan-evropiane, si Forumi Rinor Evropian. Ata adoptojnë role të shumta, me rolet në varësi të financimit të tyre, duke përfshirë nivelin e mbështetjes shtetërore si dhe përfshirjen e tyre në ofrimin e shërbimeve dhe mundësive të bazuara në projekte. Shumë shoqata rinore janë gjithashtu të përfshira në lobim dhe çuarjen përpara të punës rinore ose agjendës politike të të rinjve. Shumë prej tyre ofrojnë punë ndërkombëtare rinore dhe u ofrojnë të rinjve nga vende, prejardhje etnike dhe kultura të ndryshme mundësi për t'u takuar me njëri-tjetrin dhe për të zgjeruar njohuritë e tyre kulturore dhe për të përmirësuar aftësitë e tyre personale (d.m.th. ndërveprimi, komunikimi dhe mirëkuptimi).

Puna me të rinjtë nuk ka të bëjë aq shumë me natyrën e aktivitetit se sa me fokusin tek i riu dhe konteksti, mjedisi ose metoda.


Ka tre pjesë përbërëse kryesore të punës rinore (të përfaqësuar nga trekëndëshi bazë). Ne duhet të jemi njësoj të vetëdijshëm për të tre fushat në mënyrë që të jemi efektivë. Këto zona janë të ndërlidhura (të përfaqësuar nga rrethi). Ndërsa të rinjtë janë pjesë e bazës, ata janë gjithashtu në qendër të mënyrës se si ne e bëjmë punën tonë (të përfaqësuar nga trekëndëshi i brendshëm).

Udhëheqës/punonjës rinor

Çfarë ju sjell ju dhe kolegët tuaj për të kontribuar në punën e të rinjve? Çfarë lloj përvoja dhe kompetencash përdor secili prej jush në punën tuaj rinore? Pse jeni përfshirë? Si e organizoni punën tuaj së bashku?

Njerëz të rinj

Sa mirë i njihni të rinjtë me të cilët punoni? Cili është prejardhja e tyre? Nga vijnë ata? Cilat janë interesat e tyre? Pse marrin pjesë?



Puna

Çfarë lloj aktivitete organizoni me të rinjtë? A janë më shumë të bazuara në projekte, apo keni një qasje më afatgjatë? Sa marrin pjesë të rinjtë në marrjen e vendimeve dhe organizimin e aktiviteteve? Si e vlerësoni atë që bëni?

1.4 Puna rinore: etika

Puna rinore, edhe pse në themel të këtij sistemi janë të rinjtë, aktorët që janë të përfshirë në punën me ta kanë role të ndryshme. Edhe një punonjës rinore mund të jetë në pozicione dhe role të ndryshme duke qenë pjesë e së njëjtës organizatë rinore dhe duke punuar me të njëjtin rini për periudha më të gjata kohore. Synimi i një punonjësi rinor është i qartë, për të rritur zhvillimin personal, integrimin social dhe qytetarinë aktive të të rinjve. E njëjta gjë vlen edhe për mënyrën e arritjes së objektivave. Pra, kërkohet një kod sjelljeje dhe një etikë e caktuar për krijimin e një pune rinore cilësore.

Etika përgjithësisht konsiderohet si norma e sjelljes që ndjekin njerëzit, në lidhje me atë që është e mirë apo e keqe, e drejtë apo e gabuar. Zakonisht çështjet etike kanë të bëjnë me çështjet e mirëqenies së njerëzve (dhe kafshëve).

Etika në kontekstin e praktikës profesionale ka të bëjë me:

- Zhvillimin e aftësisë për të parë dimensionet etike të problemeve, për të reflektuar mbi çështjet, për të marrë vendime të vështira dhe për të qenë në gjendje të justifikojnë këto vendime;
- Veprimin me integritet sipas përgjegjësisë dhe detyrave të dikujt (kjo mund të përfshijë sjelljen në përputhje me parimet profesionale, udhëzimet ose rregullat përkatëse).

Sjellja e të çdokujt të përfshirë në punën dhe shërbimet për rininë (drejtuesit politikë dhe menaxherialë,

përgjegjësit, punonjësit, vullnetarët dhe pjesëmarrësit) duhet të jetë e një standardi që e bën atë bazën e:

- Ofrimit efektiv të shërbimeve;
- Modelimit të sjelljes së përshtatshme për të rinjtë;
- Besimit ndërmjet punëtorëve dhe të rinjve;
- Besimit ndërmjet organizatave, shërbimeve, prindërve dhe të rinjve;
- Gatishmërisë së palëve të ndryshme për të kushtuar resurse;
- Një besimi në kapacitetin e punës rinore për të ndihmuar vetë të rinjtë të mësojnë të marrin vendime morale dhe të ndërmarrin veprime efektive.

Kjo kërkon që të gjithë ata që janë të përfshirë duhet të jenë të aftë të mendojnë siç duhet për etikën në situata praktike. Më poshtë po sjellim një përmbledhje të deklaratës së parimeve të sjelljes etike për punën rinore.

a) Parimet etike

Punonjësit rinorë kanë angazhimin të:

1. Trajtojnë të rinjtë me respekt, duke vlerësuar çdo individ dhe duke shmangur diskriminimin negativ.
2. Respektojnë dhe promovojnë të drejtat e të rinjve për të marrë vendimet dhe zgjedhjet e tyre, përveç nëse kërcënohen seriozisht mirëqenia ose interesat legjitime të tyre ose të tjerëve.
3. Promovojnë dhe garantojnë mirëqenien dhe sigurinë e të rinjve, duke i lejuar ata të mësojnë nëpërmjet ndërmarrjes së aktiviteteve sfiduese edukative.
4. Kontribuojnë në promovimin e drejtësisë sociale për të rinjtë dhe në shoqëri në përgjithësi, nëpërmjet inkurajimit të respektit për dallimet, diversitetin dhe diskriminimi sfidues.

b) Parimet profesionale

Punonjësit rinorë kanë angazhimin të:

1. Njohin kufijtë midis jetës personale dhe asaj profesionale dhe jenë të vetëdijshëm për nevojën për të balancuar një marrëdhënie të kujdesshme dhe mbështetëse me të rinjtë me distancë të përshtatshme profesionale.
2. Njohin nevojën për të qenë të përgjegjshëm ndaj të rinjve, prindërve ose kujdestarëve të tyre, kolegëve, financuesve, shoqërisë më të gjerë dhe të tjerëve me një interes përkatës në punën, dhe se këto përgjegjësi mund të jenë në konflikt.
3. Zhvillojnë dhe ruajnë aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të kryer punën.
4. Punojnë për kushtet në vende ku këto parime diskutohen, vlerësohen dhe mbështeten.

1.5 Edukimi joformal – Themel në punën rinore

Puna rinore shpesh ka një qëllim ose dimension të fortë arsimor. Në mënyrë tipike, arsimimi ose mësimi që kërkon vendi në punën rinore është 'joformal'. Puna me të rinjtë dhe edukimi joformal kanë shumë karakteristika të përbashkëta, por nuk janë të njëjta.

Mësimi formal: zakonisht ofrohet nga një institucion arsimor ose trajnimi, i strukturuar (për sa i përket objektivave të të mësuarit, kohës së të mësuarit ose mbështetjes së të mësuarit) dhe që çon në certifikim. Të mësuarit formal është i qëllimshëm nga këndvështrimi i nxënësit.

Të mësuarit joformal: Të nxënësit, i cili zhvillohet përmes aktiviteteve të planifikuara (për sa i përket objektivave të të nxënësit, kohës së të nxënësit); mund të mbulojë programe për të dhënë aftësitë e punës, arsimimin e të rriturve etj. Rastet shumë të zakonshme të të mësuarit joformal përfshijnë trajnimin në institucione (publike dhe jopublike) përmes të cilit përditësojnë dhe përmirësojnë aftësitë e punonjësve të tyre, të mësuarit e strukturuar online dhe programe të organizuara nga organizatat e shoqërisë civile për anëtarët e tyre, grupin e tyre të synuar ose publikun e gjerë.

Mësimi informal: Mësimi që realizohet nga aktivitetet e përditshme që lidhen me punën, familjen ose kohën e lirë, i cili nuk është i organizuar ose i strukturuar në aspektin e objektivave, kohës ose mbështetjes mësimore; mund të jetë e paqëllimshme nga ana e nxënësit; shembuj të mësimin të fituar përmes të nxënësit informal janë: aftësitë e fituara përmes përvojave të jetës dhe punës, aftësitë e menaxhimit të projektit, aftësitë e TIK-ut të fituara në vendin e punës, gjuhët e mësuara, aftësitë ndërkulturore të fituara gjatë qëndrimit në një vend tjetër, aftësitë e TIK-ut të fituara jashtë vendit të punës, aftësitë e fituara përmes vullnetarizmit, aktiviteteve të punës kulturore dhe sportive në shtëpi etj.⁵

Karakteristikat thelbësore të mësimin joformal

- bashkekzistencë e ekuilibruar dhe ndërveprimi ndërmjet dimensioneve njohëse, afektive dhe praktike të të nxënësit;
- ndërlidhja e të nxënësit individual dhe social, solidariteti i orientuar drejt partneritetit dhe marrëdhëniet simetrike të mësimdhënies/të nxënësit;
- pjesëmarrës dhe me në qendër nxënësin;
- holistik dhe i orientuar nga procesi;
- shqetësime të afërta me jetën reale, me përvojë dhe të orientuar drejt të mësuarit duke bërë, duke përdorur shkëmbimet dhe takimet ndërkulturore si mjete mësimore;
- akses vullnetar dhe (idealisht) i hapur;
- synon mbi të gjitha të përcjellë dhe të praktikojë vlerat dhe aftësitë e jetës demokratike.

Metodat e mësimdhënies/trajnimin dhe të nxënësit joformal

- metodat e bazuara në komunikim: ndërveprimi, dialogu, ndërmjetësimi;
- metoda të bazuara në aktivitet: përvoja, praktikë, eksperimentim;
- metoda të fokusuar në shoqëri: partneritet, punë ekipore, rrjetëzim;
- metoda të vetëdrejtuar: kreativiteti, zbulimi, përgjegjësi.

⁵ Rekomandimi i Këshillit 2012/C 398/01

Shkurtimisht...	<ul style="list-style-type: none"> • mësimi zhvillohet jashtë strukturave të sistemit të arsimit formal dhe ndryshon nga kjo në mënyrën e organizimit dhe llojit të njohjes që jep ky mësim; • mësimi është i qëllimshëm dhe vullnetar; • mësimi synon mbi të gjitha të përcjellë dhe të praktikojë vlerat dhe aftësitë e jetës demokratike.
Veçoritë metodologjike	<ul style="list-style-type: none"> • bashkekzistencë e ekuilibruar dhe ndërveprimi ndërmjet dimensioneve njohëse, afektive dhe praktike të të nxënit; • lidh të nxënit individual dhe social; • Solidariteti i orientuar nga partneriteti dhe marrëdhëniet simetrike të mësimdhënies/të nxënit; • qasje pjesëmarrëse dhe me në qendër nxënësin; • afër shqetësimeve të jetës reale, eksperimentale dhe të orientuara drejt të mësuarit duke bërë, duke përdorur shkëmbimet dhe takimet ndërkulturore si mjete mësimore.
Vlerat	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerat që lidhen me zhvillimin personal: autonomi; mendim kritik; çiltërsi dhe kuriozitet; Kreativiteti. • Vlerat që lidhen me zhvillimin shoqëror: komunikimi; pjesëmarrja dhe qytetaria demokratike; solidariteti dhe drejtësia sociale; përgjegjësia; fuqia transformuese e konfliktit. • Vlerat etike: të drejtat e njeriut; respekt për të tjerët; mësimi dhe dialogu ndërkulturor; paqe/jo dhunë; barazia gjinore; dialogu ndër breza.
Edukatorët joformalë...	<ul style="list-style-type: none"> • përdorin metoda përfshirëse ndërvepruese; • përdorin diversitetin si një mjet pozitiv të të mësuarit; • krijojnë lidhje kritike reflektuese midis konkretes dhe abstraktes, në mënyrë që të lehtësojë procesin e të mësuarit dhe të përmirësojë vazhdimisht cilësinë e tyre; • ka njohuri për jetën dhe kulturat e të rinjve në Evropë.

1.6 Kompetencat e punës rinore

Në dekadat e fundit, puna rinore ka qenë pjesë e një ndërkombëtarizimi intensiv. Për shkak të programeve transnacionale, si Erasmus+ i Komisionit Evropian dhe atyre të ofruara nga Këshilli i Evropës, puna rinore u bë një arenë ndërkombëtare. Në këtë arenë, idetë, praktikat, partneritetet, perspektivat janë zhvilluar me një ritëm shumë të lartë dhe kjo çon në një rritje të inovacionit dhe cilësisë në fushën rinore. Për të zbatuar një zhvillim të qëndrueshëm në nivel ndërkombëtar, nevojitej një vizion

i përbashkët, si dhe mjete për të vazhduar zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të rinisë. Një iniciativë e tillë është Portofoli Evropian për liderët rinorë dhe punëtorët rinorë.

Portofoli Evropian për liderët rinorë dhe punonjësit rinorë është një iniciativë e Këshillit të Evropës në bashkëpunim me ekspertë dhe partnerë si Komisioni Evropian dhe Forumi Rinor Evropian. Ai u ofron udhëheqësve të rinjve dhe punonjësve rinorë në Evropë, vullnetarëve ose profesionistëve, një mjet që mund t'i ndihmojë ata të identifikojnë, vlerësojnë dhe përshkruajnë kompetencat e tyre bazuar në standardet evropiane të cilësisë.

Duke përdorur këtë portofol, liderët rinorë dhe punonjësit rinorë jo vetëm që do të kontribuojnë në njohjen e përvojës dhe aftësive të tyre, por edhe në përpjekjet për të rritur njohjen e punës rinore dhe edukimit/mësimin joformal. Nga funksionet e punës rinore, Portofoli përpiqet të përmirësohet shpjegojë se çfarë duhet të jenë në gjendje të bëjnë punonjësit e rinj; me fjalë të tjera, kompetencat që duhet të kenë punonjësit e rinj për të kryer punën rinore. Ky proces është shumë i rëndësishëm, sepse punëtorët rinorë janë të detyruar të jenë nxënës gjatë gjithë jetës dhe vetë puna për të rinjtë është një fushë vazhdimisht në zhvillim.

1. Funkzioni: Për të fuqizuar të rinjtë

Udhëheqësi/punonjësi rinor është në gjendje të:

- a) aftësojë të rinjtë të marrin pjesë përmes zhvillimit të veprimit kolektiv dhe të mësuarit;
- b) përfshirja e të rinjve në planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e aktiviteteve;
- c) t'u mundësojë të rinjve të punojnë drejt qëllimeve të tyre;
- d) të ndihmojë zhvillimin e besimit, njohurive, të menduarit kritik, aftësive dhe mirëkuptimit të të rinjve;
- e) kontaktojë me të rinjtë në nivel emocional;
- f) zgjerojnë vetëdijen e tyre për konceptet e pushtetit dhe ndryshimit.

2. Funkzioni: Zhvillimi i mundësive përkatëse të të mësuarit

Udhëheqësi/punonjësi rinor është në gjendje të:

- a) t'u ofrojë të rinjve udhëzimet dhe reagimet e duhura;
- b) përfitim nga mundësitë spontane të të mësuarit dhe zhvillimit në situatat e përditshme;
- c) të identifikojë ndonjë nevojë të veçantë të të mësuarit;
- d) të përdori një sërë metodash dhe teknikash edukative;
- e) stimulojë kreativitetin e të rinjve.

3. Funkzioni: Të shoqërojë të rinjtë në procesin e tyre të të mësuarit ndërkulturor

Udhëheqësi/punonjësi rinor është në gjendje të:

- a) të lehtësojë njohjen e të rinjve për sa i përket prejardhjes, vlerave dhe sjelljes së tyre kulturore;
- b) promovojnë tolerancën aktive dhe ndërveprimin me njerëzit nga kulturat e tjera brenda dhe jashtë vendit;
- c) punojnë në mënyrë krijuese me konflikte drejt zgjidhjeve paqësore;
- d) të ndihmojë të rinjtë të përcaktojnë vendin e tyre në një botë në ndryshim.

4. Funkzioni: Të kontribuojë në zhvillimin e politikave organizative dhe rinore

Udhëheqësi/punonjësi rinor është në gjendje të:

- a) gjejë burimet dhe t'i menaxhojë ato;
- b) menaxhojë të tjerët dhe të punojë në mënyrë efektive në ekip;
- c) punojë për ndryshim dhe zhvillim brenda organizatave;
- d) bashkëpunojë me të tjerët për të formuar politikën rinore.

5. Funkzioni: Për të përdorur praktikën vlerësuese

Udhëheqësi/punonjësi rinor është në gjendje të:

- a) planifikojë dhe zbatojë një sërë metodash të vlerësimit pjesëmarrës;
- b) të përdorë mjetet e duhura të teknologjisë së informacionit kur është e nevojshme;
- c) demonstrojë aftësi në shkrimin dhe prezantimin e raporteve për një sërë audiencash;
- d) hulumtojë dhe përdorë rezultatet për të ndikuar në praktikë.

Pjesa 2: Koncepte bazë

2.1 Teoria e inteligjencës së shumëfishtë

Njerëzit marrin njohuri në mënyra të ndryshme dhe secili ka aftësitë dhe talentet e veta unike mendore. Në librin e tij "Teoria e inteligjencës së shumëfishtë" (Theory of Multiple Intelligence, 1983) psikologu amerikan Howard Gardner hedh poshtë kuptimin tradicional të inteligjencës psikometrike. Sipas tij, ekzistojnë inteligjenca të shumta, të cilat janë të pavarura nga njëra-tjetra. Sipas autorit, të gjitha qeniet njerëzore zotërojnë të gjitha llojet e inteligjencës, por në shkallë të ndryshme.

Gardner fillimisht deklaroi shtatë lloje të inteligjencës dhe më vonë shtoi dy të tjera:

Gjuhësore – përfshin aftësinë për të vepruar me fjalë verbalisht (tregimtarë, folës, politikanë) si dhe me shkrim (poetë, shkrimtarë, dramaturgë, gazetarë, redaktorë).

Logjiko-matematikore – është aftësia për të vepruar me numra (matematicienë, kontabilistë, statisticienët) dhe për të menduar në mënyrë racionale (shkencëtarë, programues kompjuteri, logjikë).

Muzikor – është aftësia për të perceptuar dhe vlerësuar muzikën (kritik muzikor), për të krijuar dhe transformuar (kompozitor) dhe për të interpretuar (aktor, këngëtar). Ai që ka zhvilluar inteligjencë muzikore, i kujton lehtësisht meloditë dhe është në gjendje t'i riprodhojë ato.

Trupi-kinestetik – Përfshin aftësinë për të përdorur trupin për të shprehur veten, për të komunikuar ndjenjat dhe emocionet përmes lëvizjes (atlet, balerin, aktor) për të përdorur duart për të transformuar objekte të ndryshme (mjeshtri, skulptor, inxhinier, kirurg). Njerëz të tillë janë shumë të aftë dhe të shpejtë në veprimet e tyre.

Pamore-hapësinore – është dhuntia për të perceptuar botën vizualisht dhe për të analizuar këtë informacion (gjuetar, udhërrëfyes), si dhe për të transformuar hapësinë (arkitekt, artist, shpikës, dizajner i brendshëm). Njerëzit me këtë lloj inteligjence janë të hapur ndaj ngjyrave, formave, linjave dhe marrëdhënieve ndërmjet objekteve në hapësinë. Ata mund të shprehin grafikisht idetë e tyre.

Ndërpersonale – aftësia për të zbuluar disponimin, motivimet, synimet dhe emocionet e njerëzve të tjerë. Kjo është gjithashtu aftësia për të komunikuar, d.m.th. për të shkëmbyer informacione me njerëz të tjerë në mënyrë verbale dhe joverbale me gjuhën e shenjave, muzikën dhe të folurit (shitës, politikanë, menaxherë, mësues, punonjës socialë). Individët e këtij lloji të inteligjencës mund të flasnin dhe të negociojnë që në moshë të vogël dhe të duan të jenë mes njerëzve.

Intrapersonale – ngre ndërgjegjësimin dhe ndjeshmërinë për veten, të kuptuarit e pikave të

forta dhe të dobëta të dikujt, duke kufizuar besimet, motivimet, qëndrimet, dëshirat dhe emocionet. Njerëz të tillë kanë gjithashtu nivele të larta të vetëkontrollit, vetëkuptimit dhe vetëvlerësimit (psikolog, psikiatër dhe filozof).

Natyaliste – natyalistët kanë aftësinë për të kuptuar natyrën dhe për të zbuluar rregullsitë; lundrojnë midis shumë organizmave të gjallë (botanist, veteriner, pylltar). Ata janë gjithashtu të ndjeshëm dhe kujdesen për disa veçori të botës që i rrethon (meteorolog, gjeolog, arkeolog).

Ekzistenciale – aftësia dhe vullneti për të formuluar pyetje rreth jetës, vdekjes dhe pyetjeve të tjera ekzistenciale.

2.2 Cikli i trajnimit: Procesi dhe facilituesi/ lehtësuesi

2.2.1 Përvojë konkrete

Përshkrim: Pjesëmarrësit mbledhin informacion dhe fitojnë një lloj eksperience specifike. Përvoja lidhet gjithmonë me lojërat dhe argëtimin.

Teknikat dhe instrumentet

- Aktivitete individuale dhe grupe (mund të kryhen individualisht, në çifte, në një grup prej tre personash, grupe të vogla, midis formacioneve të ndryshme grupe ose grupeve më të mëdha)
- Ndërveprimi ndërpersonal
- Pothuajse çdo aktivitet që lidhet me vetëvlerësimin e liderit
- Krijimi i produkteve dhe moduleve
- Zgjidhja e problemeve
- Ndarja e informacionit
- Dhënia dhe marrja e komenteve
- Zgjidhja e rastit
- Lojëra me role

Qëllimi: Për të pasur një përvojë të përbashkët, për të zhvilluar një bazë të dhënash të përbashkët për t'u përdorur gjatë fazave të ardhshme.

Modeli bazohet në mësimin induktiv. Kjo do të thotë që një zbulim (pa marrë parasysh se çfarë ndodh gjatë një aktiviteti të caktuar, ose nëse pritet apo jo) bëhet bazë për analizë kritike dhe pjesëmarrësit mund të marrin njohuri me zbulime të rastësishme.

E rëndësishme:

- Lehtësuesi duhet të jetë i kujdesshëm që të mos gjenerojë një sasi të tepërt informacioni ose një mjedis që do të pengojë diskutimin e rezultateve.
- Nëse procesi ndalon pas kësaj faze, kjo do të thotë se trajnimi është lënë në fat dhe moderatori nuk është i aftë të arrijë qëllimet e të mësuarit që janë vendosur.

2.2.2 Vëzhgimi dhe reagimi

Përshkrim: Pjesëmarrësit tashmë kanë përvojë individuale dhe të përbashkët nga një aktivitet i caktuar dhe diskutojnë atë që panë dhe ndjenë gjatë ngjarjes (në nivel kognitiv, emocional dhe të sjelljes).

Teknikat dhe instrumentet

- Regjistrimi me video i ngjarjeve gjatë fazës së parë (për të lehtësuar kalimin nga faza fillestare, për një diskutim të mëvonshëm).
- Ndarja në grupe të vogla dhe gjenerimi i informacionit të asaj që ndien dhe panë pjesëmarrësit.
- Pasqyrimi i përvojës së të gjithë pjesëmarrësve nga grupet e mëdha në një flipchart.
- Përdorimi i shoqatave të lira për tema të ndryshme që lidhen me veprimtarinë që në fazën e parë.
- Puna në çifte që pyesin njëri-tjetrin për fazën e parë (Çfarë? Si?).
- Vlerësimi i produktivitetit, kënaqësisë, nivelit të besimit, komunikimit, lidershit.
- Intervistë e strukturuar e pjesëmarrësve për përvojën e tyre gjatë aktivitetit.
- Diskutime të strukturuar dhe të lira

Kuptimi: Përvoja personale e secilit pjesëmarrës bëhet e disponueshme për të gjithë grupin.

E rëndësishme:

Pjesëmarrësit duhet të mbahen brenda temës së shkëmbimit të vëzhgimeve dhe reagimeve. Lehtësuesi duhet të jetë i vëmendshëm dhe t'i pengojë ata të kalojnë në fazën e Reflektimit ose drejt në fazën e Përmbledhjes (zbritja e parimeve në bazë të asaj që tashmë ka ndodhur).

2.2.3 Reflektimi

Përshkrim: Kjo është e ashtuquajtura nën-fazë e dinamikës së grupit të ciklit dhe mund të shihet si hapi më i rëndësishëm në trajnimin eksperimental. Reflektimi është një hulumtim sistematik i përvojave të përbashkëta të pjesëmarrësve. Gjatë procesit ata rindërtojnë modelet dhe ndërveprimet nga aktiviteti i shkëmbimit të informacionit të kryer në fazën e vëzhgimit. Pjesëmarrësit duhet t'i përgjigjen pyetjes "Çfarë ndodhi në të vërtetë?" në lidhje me proceset e dinamikës së grupit dhe jo në lidhje me kuptimin aktual të ngjarjes.

Teknika dhe instrumente

- Reagimet u fokusuan në rolet e pjesëmarrësve dhe ndikimin e tyre gjatë aktivitetit në fazën e parë.
- Vëzhgimi i procesit me deklaratat, panel diskutime.
- Diskutimet tematike në kërkim të temave të përsëritura në deklaratat e të trajnuarve.
- Pyetësorët e zhvilluar për këtë qëllim.
- Hulumtimi i të dhënave që u mblodhën në nën-fazën e mëparshme.
- Përdorimi i fjalëve kyçe për drejtimin e diskutimit.

E rëndësishme:

- Vetëdija – aftësia për të njohur emocionet e dikujt, pikat e forta, dobësitë, shtysat, vlerat dhe qëllimet; njohin ndikimin e tyre tek të tjerët ndërsa përdorin ndjenjat e brendshme për të udhëhequr vendimet.
- Vetërregullimi – përfshin kontrollin ose ridrejtimin e emocioneve dhe impulseve përçarëse të dikujt dhe përshtatjen me rrethanat në ndryshim.
- Aftësitë sociale – menaxhimi i marrëdhënieve për të lëvizur njerëzit në drejtimin e dëshiruar.
- Empatia – merr parasysh ndjenjat e njerëzve të tjerë veçanërisht kur merren vendime.
- Motivimi – nxitja për të arritur për hir të përmbushjes së rezultateve.

Kompetencat emocionale nuk janë talente të lindura, por aftësi të mësuara mbi të cilat duhen punuar dhe mund të zhvillohen për të arritur performancë të jashtëzakonshme. Goleman parashtron se individët lindin me një inteligjencë të përgjithshme emocionale që përcakton potencialin e tyre për të mësuar kompetenca emocionale.

2.8 Këshillimi rinor

Çfarë është një Këshillues Rinor?

Një këshillues për të rinjtë është dikush që ofron mbështetje dhe udhëzime për të rinjtë që shihen si 'në rrezik' ose që kanë kryer krime – zakonisht deri në vitet e tyre të adoleshencës. Këshilluesit rinorë mund të përfshihen për të ofruar mbështetje në një sërë çështjesh që prekin këtë kategori popullore, të cilat

⁶ Për më shumë detaje shihni "Çfarë e bën një udhëheqës" nga Daniel Goleman, më e mira e Harvard Business Review 1998

ndikojnë në zhvillimin e tyre social ose arsimor. Shembuj të çështjeve të tilla përfshijnë jetë të paqëndrueshme në shtëpi, bullizëm ose shqetësime për imazhin e trupit etj.

Përveç mbështetjes, një këshillues për të rinjtë është gjithashtu një pikë kontakti për të rinjtë, për të mësuar rreth shërbimeve vendore dhe për të ofruar një rol kyç në prezantimin me shërbimet e specializuara për çështjet e tyre të interesit. Këshilluesit rinorë gjenden të punësuar në një sërë mjedisesh, duke përfshirë shkollat, brenda sistemit të drejtësisë penale dhe shërbimeve sociale – kjo i vendos ata në një pozicion të mirë për t'u angazhuar me të rinjtë që po përjetojnë probleme ose që shihet se janë në rrezik të zhvillimit të çështjeve të vazhdueshme.

Çfarë bën një këshillues i të rinjve?

Këshilluesit për të rinjtë ofrojnë udhëzime, informacione dhe disa menaxhim të rasteve për të rinjtë e moshave 11-21 vjeç, të cilët përndryshe mund të mbeten pa mbështetje. Këshilluesit punojnë gjithashtu në një sërë çështjesh problemore me këta të rinj, të tilla si: abuzimi me substancat, trauma, aftësitë sociale, mosarritjet akademike dhe çështjet familjare.

Këshilluesit e të rinjve përdorin një shumëllojshmëri të gjerë të aftësive profesionale për tu ardhur në ndihmë atyre. Teknika e parë dhe më e rëndësishme është zhvillimi i raportit me një të ri; për ta vendosur veten si një i rritur miqësor, i besueshëm, i cili ka primare interesat dhe suksesin më të mirë të të riut. Teknikat e ndërtimit të besimit si vetëzbulimi i kujdesshëm, rishikimi i plotë i politikave të konfidencialitetit dhe diskutimet e qëllimshme të transferimit dhe kundërtransferimit janë disa nga mjetet e linjës së parë për ndërtimin e raporteve me të rinjtë mosbesues.

Pasi të krijohet raporti, shumë këshillues të rinjsh përdorin teknikat e terapisë konjitive të sjelljes, e cila përfshin shqyrtimin në mënyrë bashkëpunuese të ndërveprimit midis mendimeve, sjelljeve dhe ndjenjave të një të ri. Shumë këshillues e kalojnë fazën e ndërtimit të raportit në një përpjekje për të thjeshtuar trajtimin, por ky është një gabim. Pa raport, të rinjtë do të përfitojnë shumë pak nga këshillimi.

Brenda modelit kognitiv, besohet se një ndryshim në mendime, sjellje ose ndjenja mund të lehtësojë ndryshimin në dy kategoritë e tjera. Për shembull, nëse një këshillues dhe një i ri po punojnë në bashkëpunim dhe vendosin të fokusohen në ndryshimin e sjelljes së të rinjve në një klasë të caktuar akademike me shpresën për të përmirësuar gjendjen e të rinjve, nota, ata mund të fokusohen në zhvendosjen e mendimeve të të rinjve për mësuesin nga negative në neutrale.

Këshilluesit e të rinjve që punojnë me të rinjtë mund të përdorin një sërë teknikash, të cilat përfshijnë intervistimin motivues, këshillimin e specializuar për abuzimin me substancat dhe programe të ndryshme të krijuara nga qarku që fokusohen te të rinjtë.

Disa këshillues të rinjsh gjithashtu përfshijnë terapinë familjare në trajtimin e tyre nëse besojnë se të rinjtë do të përfitonin prej saj. Teknika të tjera mund të përfshijnë terapinë e artit, ditarin dhe teknikat psiko-dinamike. Bashkëpunimi me të rriturit e tjerë në jetën e të rinjve është pothuajse gjithmonë i dobishëm, por duhet të bëhet në një mënyrë që të mos cenojë konfidencialitetin dhe për rrjedhojë besimin e të rinjve.

Pse kemi nevojë për këshillues të rinj?

Të punosh si këshillues me të rinj mund të jetë një nga punët më shpërblyese në botë. Adoleshentët shpesh janë të bombarduar nga stresa të brendshme si dhe të jashtëm, të cilët kanë nevojë për udhëzime për t'i zgjidhur ato. Ndonjëherë këta të rinj kanë pasur vështirësi në shkollë ose në shtëpi dhe familjet e tyre kërkojnë një këshillues për të rinjtë, i cili mund ta ndihmojë adoleshentin të identifikojë problemet e tij/saj dhe t'i zgjidhë ato. Herë të tjera, të rinjtë dërgohen te një këshillues pas një incidenti të madh si krimi ose kërcënimi, në këto raste të rinjve u kërkohet të marrin pjesë në seancat me një këshillues përpara se të kthehen në shkollë ose në shtëpi me familjen e tyre.

Ku punon një këshillues i të rinjve?

Këshilluesit e të rinjve punojnë në një mjedis shkollor, ku ata flasin me nxënësit gjatë gjithë ditës për çështje që zakonisht hasin adoleshentët. Studentët individualë mund të vijnë në zyrën e këshilluesit kur kanë çështje që do të donin të diskutonin ose kur një mësues kërkon që ata të vizitojnë këshilluesin.

Mjedise të tjera pune mund të përfshijnë organizata joqeveritare, institucione të qeverisjes vendore apo qendrore, këshilla vendorë rinorë etj.

2.9 Orientimi në karrierë

Çfarë është Këshillimi i Karrierës?

Ndërsa rriten, disa njerëz duan të bëhen astronautë, oficerë policie, shoferë makinash garash, mësues, mjekë, infermierë etj. Sigurisht, zgjedhjet e para të karrierës nuk funksionojnë gjithmonë. Në fakt, studimet tregojnë se mbi gjysma e individëve janë të pakënaqur me punën dhe karrierën e tyre. Këshillimi për karrierë ofron një mënyrë për ta ndryshuar këtë gjë. Ky është një lloj këshillimi që fokusohet në ndihmën e njerëzve për të bërë më të mirën e karrierës së tyre, pavarësisht nëse ata po planifikojnë të ardhmen e tyre profesionale, sapo e kanë filluar atë ose kanë qenë në një punë më shumë se sa do të donin.

Një nga librat e parë të rëndësishëm të shkruar mbi temën e këshillimit dhe udhëzimit në karrierë ishte "*Zgjedhja e një profesioni*" nga Frank Parson në 1909. Katharine Briggs doli me idenë e llojeve të ndryshme të personalitetit në fillim të shekullit të 20-të. Ky test u përdor fillimisht gjatë Luftës së Dytë Botërore për të ndihmuar në vendosjen e grave në pozicione në fuqinë punëtore industriale, në varësi të llojeve të tyre të personalitetit.

Pse kemi nevojë për këshilltarë të karrierës?

Njerëzit punojnë në mënyrë që të jenë në gjendje të përballojnë të jetojnë jetën që dëshirojnë. Karriera dhe puna janë domosdoshmëri thelbësore në jetë për shumicën e të rriturve në botë. Shumica e njerëzve do të kalojnë të paktën një të katërtën e jetës së tyre të rritur duke punuar.

Këshillimi për karrierë mund t'i ndihmojë njerëzit t'i drejtojnë në drejtimin e duhur kur bëhet fjalë për

zgjedhjen e karrierave në të cilat ata do të shkëlqejnë dhe do të jenë të lumtur. Të qenit i lumtur me një karrierë mund të çojë në një jetë më të lumtur në shtëpi dhe një ndjenjë më të madhe arritjeje.

Çfarë bën një këshillues karriere?

Këshilluesit e karrierës punojnë me të gjithë llojet e njerëzve, nga të gjitha sferat e jetës, të të gjitha moshave, me të gjitha nivelet e ndryshme të arsimit dhe përvojës. Këta profesionistë mund të ofrojnë udhëzime dhe këshilla, për shembull, për biznesmenët e fuqishëm apo edhe fëmijët e shkollave të mesme që sapo kanë filluar në botë.

Qëllimi kryesor i një këshilluesi karriere është të ndihmojë individët të gjejnë karriera që u përshtaten atyre dhe karriera për të cilat janë të suksesshëm në tregun e punës. Ka një sërë gjërash që këshilluesit e karrierës mund të dëshirojnë t'i marrin parasysh kur përpiqen të përmbushin këtë detyrë.

Qëndrimi dhe aftësitë: Aftësitë dhe shkathtësitë e një personi i referohen potencialit të tij për të bërë diçka. Këshilluesit e karrierës shpesh do të intervistojnë dhe testojnë individët për të përcaktuar se ku qëndrojnë pikat e tyre të forta, dhe për rrjedhojë, në cilat karriera do të ishin të mirë.

Arsimi: Këshilluesit e karrierës zakonisht do të marrin në konsideratë gjithashtu edhe nivelin arsimor të individit (ose nivelin e dëshiruar të arsimit), kur përpiqen ta ndihmojnë atë të gjejë karrierën e duhur, pasi shumë karriera kërkojnë një sasi të caktuar edukimi. Këta këshillues mund të konsiderojnë gjithashtu nëse është apo jo e mundur ose e këshillueshme që një person të vazhdojë shkollimin e tij/saj.

Personaliteti: Personaliteti i një personi gjithashtu zakonisht luan një rol në përcaktimin e karrierës më të mirë për të, pasi tipe të ndryshëm personaliteti zakonisht shkëlqejnë në lloje të ndryshme karrierash.

Interesat: Këshilluesit e karrierës gjithashtu marrin parasysh interesat e individëve që po këshillojnë për opsionet më të mira të karrierës për ta.

Për të përcaktuar disa nga këta faktorë, këshilluesit e karrierës shpesh u kërkojnë individëve që po këshillojnë që të bëjnë një sërë testesh dhe anketash. Për shembull, ata mund të bëjnë teste për IQ dhe aftësi, si dhe të plotësojnë pyetësorë mbi interesat dhe aftësitë e tyre. Këshilluesit e karrierës gjithashtu zakonisht do t'i ndihmojnë të hulumtojnë dhe të fillojnë në karrierën e tyre të re. Kjo mund të përfshijë ndihmën e tyre për të kërkuar punë së bashku me shkrimin e CV-ve dhe letrave motivuese etj.

Pjesa 3: Aftësi praktike

3.1 Vlerësimi i nevojave të të rinjve

Në botën reale, nuk ka asnjëherë burime financiare të mjaftueshme për të përmbushur të gjitha nevojat.

Vlerësimet e nevojave kryhen për të ndihmuar planifikuesit e programit të identifikojnë dhe zgjedhin punën e duhur.

- Një "nevojë" është një mospërputhje ose hendek midis "çfarë është" dhe "ajo që duhet të jetë".
- Një "vlerësimi i nevojave" është një grup sistematik procedurash që përdoren për të përcaktuar nevojat, për të shqyrtuar ato natyrën, shkaqet, si edhe cakton prioritetet për veprimet e ardhshme.
- Grupi i synuar": Vlerësimet e nevojave fokusohen në grupe të caktuara të synuara në një sistem. Grupet e synuara të përbashkëta në mjediset arsimore përfshijnë studentët, prindërit, mësuesit, administratorët dhe komunitetin në përgjithësi.

Në mënyrë ideale, vlerësimet e nevojave fillimisht kryhet për të përcaktuar kërkesat e njerëzve (d.m.th., marrësve të shërbimeve), për të cilët ekziston organizata ose sistemi (p.sh. studentët). Megjithatë, një vlerësim "gjithëpërfshirës" i nevojave shpesh merr parasysh nevojat e identifikuara në pjesë të tjera të një sistemi, si për shembull, mësuesit, njerëzit që kanë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me marrësit e shërbimeve, ose "çështjet e sistemit" (p.sh. disponueshmëria e programeve, shërbimeve dhe personelit etj.).

"Vlerësimi i nevojave" fokusohet në përfundimet, rezultatet që duhen arritur, në vend të procesit. Për shembull, arritja në lexim është një rezultat, ndërsa mësimi i leximit është një mjet për këtë qëllim. Ai mbledh të dhëna me anë të procedurave dhe metodave të projektuara për qëllime specifike. Llojet dhe qëllimi i metodave janë zgjedhur për t'iu përshtatur qëllimeve dhe kontekstit të vlerësimit të nevojave, duke vendosur prioritetet dhe përcaktuar kriteret për zgjidhje në mënyrë që planifikuesit dhe menaxherët të mund të marrin vendime të shëndosha.

3.2 Taksonomia e objektivave të të mësuarit

Çfarë është një qëllim?

- Sipas përkufizimit filozofiko-sociologjik qëllimi është rezultat mendor dhe i dëshiruar i një veprimtarie të caktuar.
- Në pedagogji qëllimi është rezultati mendor dhe i dëshiruar (i mundshëm dhe i synuar) nga një aktivitet trajnues (në të cilin merren parasysh kushtet e favorshme dhe të pafavorshme).

Zonat e Veprimit

- *Njohës* – Fusha përfshin synime nga kujtesa dhe riprodhimi i materialit të studiuar deri te zgjidhja e problemeve. Gjatë procesit, njohuritë ekzistuese duhet të rishqyrtohen, ose të futen në kombinime të reja së bashku me idetë, metodat, procedurat (modelet e veprimit) të studiuar më parë, duke përfshirë edhe mundësinë për të filluar procesin e gjetjes së zgjidhjeve të reja.
- *Afektive* (vlerë emocionale) – Përfshin qëllimet e vendosjes së marrëdhënieve personale emocionale me ngjarjet në botën përreth nga perceptimi i thjeshtë, interesi, gatishmëria për t'iu përgjigjur përvetësimit të orientimeve dhe qëndrimeve të vlerave dhe manifestimit të tyre aktiv.
- Në këtë fushë bien qëllime të tilla si formimi i interesave dhe prirjeve, përjetimi i emocioneve të

ndryshme, formimi i një qëndrimi, ndërgjegjësimi dhe shfaqja e tij në veprimtari.

- *Psikomotor* – Përfshin objektiva që lidhen me formimin e llojeve të ndryshme të aktivitetit motorik, të aktivitetit manipulues dhe koordinimit neuromuskular. Kjo fushë ka të bëjë me shprehitë e të shkruarit dhe të të folurit, si dhe synon qëllimet e vendosura brenda aftësive fizike dhe të punës.

Aplikimi i taksonomisë

- Në çdo fushë veprimi dallohen nivele të ndryshme të cilat rregullohen sipas parimit "nga e thjeshta në komplekse".
- Këto nivele mund të shqyrtohen si faza të ndryshme të vështirësisë - për të përfunduar një nivel të caktuar, paraprakisht duhet të zotërohet niveli i mëparshëm. Qasja mundëson matjen e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të studentëve. Taksonomia përdoret për klasifikimin e qëllimeve në procesin mësimor.

3.3 Njihu me grupin/individin

Para se të nisni punën duhet të njihni individin apo grupin për të cilin dhe me të cilin do të punoni për ta fuqizuar duke i rritur kapacitetet në aftësi dhe shkathtësi.

Përpara se të vendosni se çfarë aktivitetesh, projektesh apo punëtorie do të zbatoni me individin apo me grupin tuaj, është mirë që në fillim të dini më shumë mbi:

- Këndvështrimet e tij/tyre;
- Çfarë dinë dhe ndiejnë për gjërat;
- Çfarë do të donin të mësonin;
- Cilat janë mënyrat e tyre të komunikimit, nocionet e barazisë, nocionet e rrezikut të pritshëm dhe mbi vetëpërbushjen;
- A janë të njohur ata me metodat e edukimit joformal;
- Cili është niveli i tyre në gjuhën që po përdoret në aktivitetin komunikues të planifikuar.

Është thelbësore të pasqyroni dhe të reflektoni ndërgjegjësimin kulturor gjatë kohës që punoni me të rinj, të cilët mund të kenë tipologji, personalitete, historik, formim etj. të ndryshëm. Nëse ju kuptoni (njihni) prejardhjen kulturore dhe pritshmëritë e pjesëmarrësve, atëherë do të mund të zhvilloni trajnime më efektive.

- Tregoni respekt ndaj përvojave të tyre dhe dëgjoni shqetësimet, pritshmëritë dhe dëshirat që ata kanë.
- Vëzhgoni sjelljen dhe reagoni ndaj tyre duke bërë pyetje përgjatë aktivitetit. Kini parasysh se ndonjëherë do të punoni me të rinj që vijnë nga vende dhe me përvoja të ndryshme.
- Sigurohuni që çdo aktivitet (përfshirë dhe lojërat) të përfshijnë një seancë përmbledhje dhe vlerësimi. Kjo është shumë e rëndësishme për ata pjesëmarrës të cilët kanë pak ose aspak eksperiencë me metodat e edukimit joformal.

- Jini të durueshëm, do të duhet pak kohë që ata të mësohen më këtë metodë mësimi.
- Përqendrohuni në njohjen me njëri-tjetrin dhe aktivitetet e krijimit të ekipit përpara se të filloni trajnimet edukative mbi tema të ndryshme.
- Punoni në grupe të vogla në mënyrë që t'i kushtoni vëmendjen e duhur çdo pjesëmarrësi.
- Zgjidhni lojëra argëtuese me udhëzime të thjeshta. Lojërat e ndërlikuara, fjalori kompleks dhe të folurit shumë mund t'i mërzhisin pjesëmarrësit.

ANEKS: SHEMBUJ PUNËTORISH

TEMA: Fuqizimi, bashkëpunimi dhe krijimi i ekipit, ndërtimi i marrëdhënieve me të rinjtë, lojëra argëtuese

NR PJESËMARRËSVE: 12 persona

KOHA: 60 minuta (mund të zgjasë pak më tepër për shkak të përkthimit).

Vështrim i përgjithshëm: Fokusi kryesor i aktivitetit është ndërtimi i një marrëdhënieje me grupet e ndryshme për të theksuar vlerat e bashkëpunimit, aftësive dëgjuese, lidershit dhe krijimit të ekipit nëpërmjet metodave të edukimit joformal. Workshop-i është zhvilluar në një mënyrë të tillë që të kapërcejë lehtësisht barrierat e mundshme dhe për të punuar me komunikimin joverbal.

Qëllimi: Fuqizimi i të rinjve për të bashkëpunuar në arritjen e qëllimit kryesor me anëtarët e grupit.

Objektivat:

1. Të krijohet një marrëdhënie e mirë ndërmjet trajnerëve dhe pjesëmarrësve;
2. Të krijohet një terren i fortë bashkëpunues për të ardhmen;
3. Të kapërcehen pengesat e mundshme.

Materialet:

- Karrige;
- Letër + Shënues (për "Pica e Vlerësimit");
- 100 gota plastike të madhësisë së njëjtë;
- Llastiqe të vogla (duhet të fiksohet rreth një gotë plastike);
- 4 ose 5 fije litari/pe (rreth 61 cm).

Përgatitja:

- Pritini në 4 ose 5 pjesë të gjata litarin (61 cm) për secilin grup;
- Lidhni secilën pjesë të fijes përgjatë llastikut (të ndarë në mënyrë të barabartë), do të duket si një oktapod me katër këmbë;
- Vizatoni Picën e Vlerësimit;
- Në rrethin e jashtëm shkruani: argëtuese, interesante, e mirë përgatitur, tërheqëse, edukuese, argëtuese etj.

“Loja me karrige”

- Vendosini karriget në një rreth sipas numrit të pjesëmarrësve (fillojeni me një karrige më pak);
- Vendosini karriget mbrapsht, pra ndenjset në pjesën e jashtme të rrethit;
- Zgjidhni një këngë dhe bëjini pjesëmarrësit të vrapojnë rreth karrigeve kur muzika të fillojë;
- Udhëzoni pjesëmarrësit që të ulen pranë një karrige kur të ndalojë muzika. Kur muzika të ndalojë të gjithë lojtarët duhet të gjejnë një karrige ku të ulen. Do të mbetet një lojtar pa u ulur në karrige sepse atje është një karrige më pak se numri i lojtarëve.
- Lojtari i cili nuk gjen një karrige për t'u ulur do të mbetet jashtë loje.

Këshillë: Trajnerët mund të marrin pjesë në lojë. Ata mund t'i inkurajojnë të gjithë të jenë aktivë gjatë vrapimit përreth rrethit dhe të përfshijnë njerëzit jashtë rrethit, të cilët duhet të krijojnë një mjedis suportues për lojtarët.

“Loja e emrave”

- Trajnuesi mund të nisë lojën dhe të jetë personi i parë që shkon në qendër të rrethit;
- Kërkojini personit të prezantohet me emrin e tij, por udhëzoni të bëjnë ndonjë lëvizje ose një veprim për secilën rrokje të emrit;
- Çdo person në grup përsërit emrin e personit duke imituar lëvizjet që ai bënte;
- Lëreni personin që të përsërisë emrin dhe lëvizjet e tij aq herë sa i duhet pjesës më të madh të grupit për ta fiksuar saktë dhe më pas kaloni te pjesëmarrësi tjetër;
- Personi në të djathtë të atij që bën prezantimin duhet të shkojë para, derisa të gjithë lojtarët të jenë prezantuar me një emër dhe veprimet gjithashtu.

“Kulla me gota”

- Secili grup qëndron i ulur në formë rreth, përreth gotave, të cilat do të vendosen ose në dysheme ose në tavolinë;
- Secilit grup jepini të njëjtin numër gotash;
- Shpërndajini gotat (me fytyrë poshtë) në formë rrethi në mes të secilit grup.

Udhëzime për grupet:

- Ndërtoni një kullë me gota duke punura së bashku;
- Në raundin e parë vendosini të gjitha kupat me fytyrë nga dyshemeja;
- Anëtarët e ekipit nuk mund të prekin gotat me duar dhe as me ndonjë pjesë tjetër të trupin (edhe nëse gota rrëzohet);
- Çdo person duhet të mbajë një nga fijet që janë ngjitur në llastik;
- Grupi mund të përdori “oktapodin” me llastik vetëm për të marrë kupat dhe për t’i vënë ato njëra mbi tjetrën (duke tërhequr dhe duke lëshuar fijet për t’i vënë te filxhani.
- Nëse ka më pak se 5 persona në ekip zgjidhni një anëtarë të ekipit që të mbajë më shumë se një varg;
- Nëse koha ju mjafton, provoni të bëni disa raunde. Mundohuni që t’i mbani kupat drejt deri për raundin e dytë. Për raundin e tretë merrni disa gota duke i mbajtur drejt dhe një duke e mbajtur poshtë, në anët e tyre;
- Çdo gjë është e mundur për të realizuar sfidën (caktimi i një afati kohor, marrja e kupave nga dyshemeja, ndërtimi i kullës mbi tavolinë, pa folur...).

Diskutimi i pyetjeve:

- Si ishte të punonit në grup? E lehtë apo e vështirë? Pse?
- Si ishte komunikimi? Ju folët apo dëgjuat më shumë?

- A ishte e dobishme për ju?
- Çfarë mësove nga kjo lojë?
- Mund të gjeni ngjashmëri ndërmjet lojës dhe jetës reale?

Shënim! Nëse pjesëmarrësit s’mund të bëjnë dot lidhjen e të mësuarit me lojëra dhe jetës reale, ju mund t’i prezantoni temat e mëposhtme: ndihma dhe mbështetja te të tjerët, rëndësia e bashkëpunimit, puna në grup etj.

Pyetje dhe vlerësim

- ✓ Vizatoni një rreth në formë pice, ku pjesëmarrësit të thonë se cili aktivitet u pëlqeu më shumë. Shpjegojuni që ata mund të shënojnë firmën e tyre në mes të rrethit të picës për aktivitetin që pëlqyen më shumë. Aktivitetet më pak të pëlqyera do të shënohen sa më larg qendrës së rrethit;
- ✓ Rrethi do të ketë kategorinë e mëposhtme: emrat e lojërave, loja me karrige, gotat, të mësuarit, si ndiheni?
- ✓ Në fund mos harroni që të rishikoni dhe të përmbledhni mendimet e të gjithë pjesëmarrësve (Mund të jetë e dobishme t’i shkruani me fjalët që ata i kuptojnë më mirë, për të qenë më komod në zhvillimin e pyetjeve dhe të vlerësimit).

Këshilla për trajnuesit

- Jepni udhëzime të qarta dhe shpjegoni idenë e përgjithshme.
- Shpjegojuni pjesëmarrësve që nëse ata nuk kuptojnë diçka, janë të lirë t’u pyesin në çdo kohë. Pyetini disa herë nëse të gjithë mund t’ju ndjekin.
- Nëse ju shkruani diçka ,do të ishte më e lehtë ta përshtatnit me një term tjetër, të cilën ata mund ta kuptojnë.
- Ju mund të bëni në “marrëveshje/ rregullore” sepse disa nga aktivitetet janë tepër energjike dhe ju duhet të dakordësoni që është e parrezikshme.
- Mos harroni të bëni vlerësimin dhe reflektimin në fund dhe merrni mendimin e secilit.
- Jini të vëmendshëm se mund të ndodhin të papritura, p.sh., një pjesëmarrës mund të largohet pa thënë arsyen (dakordësoni më parë se kush do të merret me këtë nëse ndodhin raste të tilla).

Tema 2: Puna, Diskriminimi dhe Intoleranca

NR. I PJESËMARRËSVE: 8-16 (grupe të vogla)

KOHA: 60 minuta

Përmbledhje: Ky është një simulim, që u prezanton njerëzve realitetin e tregut të punës. Ai i adresohet çështjeve si:

- Pabarazia gjinore në tregun e punës;
- Paga të ndryshme për të njëjtën punë;

- Diskriminimi në vendin e punës.

Qëllimi: Rritja e ndërgjegjësimit mbi pabarazinë gjinore në tregun e punës.

Objektivat:

- Të ballafaqojmë pjesëmarrësit me realitetin diskriminues në tregun e punës;
- Promovimi i solidaritetit, barazisë dhe drejtësisë;
- Zhvillimi i aftësive bashkëpunuese;
- Zhvillimi i kreativitetit;
- Zhvillimi i të menduarit kritik dhe logjik.

Materialet:

- Trajnerë facilitues (1 për secilin grup)
- Dhoma (ambienti) mjaftueshëm e madhe për 4 grupe të vogla
- Tabelë + tabelë me letra (flip-charter paper), shënues
- Vendosini në 2 ngjyra të ndryshme (1 për pjesëmarrës, nr i barabartë ngjyrash)
- Para artificiale (fallco)
- letra formati A4
- 6 foto me 3 mjete transporti (2x lirë, 2x shtrenjtë, 2x luks)
- 6 foto me 3 lloje ushqimesh (2x lirë, 2x shtrenjtë, 2x luks)
- Ngjitës shirit, gërshërë
- 1 pako me biskota (pa çokollatë!)
- Materiale për të ndërtuar një kullë (e njëjtë për secilin grup): 1x flipchart paper (tabelë), 5x fleta formati A4, 4x lapsa, 2x gota plastike, 20 cm shirit ngjitës
- 8 shkrepëse të mëdha
- Speaker + muzikë
- 1 zile (opsionale)

Përgatitja:

- Përgatisni etiketa shumëngjyrëshe për çdo ekip. Shkruani mbi to nr. e ekipeve. Ngjyra e etiketave përfaqëson gjininë(F/M)
- 2 skuadra do të marrin 1 ngjyrë, 2 të tjerë një tjetër. Shënoni në një rreth një nr. që përfaqëson një grua shtatzënë, te ekipi i femrave
- Shkruani çmimin e mjeteve të transportit (lirë: 4000, shtrenjtë 6000, luks 10000) dhe ushqimi (lirë: 2000, shtrenjtë 4000, luks 6000) poshtë fotove
- Ndani paratë fallco ndërmjet trajnerë (1 merr 10000, 3 të tjerët marrin 12000 secili)
- Çdo trajnerë përgatit vendin së bashku me materialet e nevojshme
- Vizatoni Picën e Vlerësimit.

Udhëzim

- Ndajini pjesëmarrësit në 4 skuadra (nëse është e mundur, në nr. të barabartë pjesëmarrësish në secilin ekip)
- Jepuni pjesëmarrësve etiketat me nr. e ekipit dhe t'i veshin në një vend të dukshëm (p.sh. t'i ngjisin në rroba) përgjatë aktivitetit. 2 ekipe do të kenë një ngjyrë dhe dy të tjerat do të kenë ngjyrë tjetër. Çdo ngjyrë përfaqëson një gjini (mos ua zbuloni këtë pjesëmarrësve).
- Shpjegojuni pjesëmarrësve që janë qytetarë nga i njëjti shtet dhe që sot u duhet të punojnë në 4 punë të ndryshme që të fitojnë para. Çdo punë konsiston në 1 aktivitet 5 minutash. Në çdo punë duhet të jetë një grup që kur të mbaroj aktiviteti duhet të rrotullohen derisa të përfundohen të 4 punët.
- Katër punët mund të ndryshojnë.

Këtu kemi 4 punë sugjeruese:

Kompania e kërcimit

në 5 minuta pjesëmarrësit duhet të krijojnë një koreografi me partnerin e tyre. Përgjatë kërcimit ata duhet të baskojnë duart.

Fabrika e biskotave

Pjesëmarrësit duhet të vendosin një biskotë në ballin e tyre e më pas ta hanë pa përdorur duart.




Kompania e ndërtimit

Pjesëmarrësit duhet të ndërtojnë një kullë sa më të lartë të mundshme, me të gjitha materialet e dhëna.

Kompania matematikore

Pjesëmarrësit duhet të zgjidhin një problem matematikor në më pak se 5 minuta.



Udhëzime:

- Pas mbarimit të detyrave pjesëmarrësit do të marrin një pagesë. Ekipet me ngjyrën e burrave do të marrin 4000 për çdo detyrë, ndërsa grupet me ngjyrën e grave do marrin 2000. Shënoni që grupi me gruan shtatzënë nuk do të pranohet në grupin e kërcimit.
- Trajnerët do të trajtojnë ndryshe çdo grup. Kur të punojnë me ekipin e grupit të femrave trajnerët duhet të flirtojnë me ta dhe të tregojnë më pak pritshmëri ndaj këtyre ekipeve të etiketuara të femrave.
- Grupet duhet të mblidhen në një rreth për të numëruar paratë e tyre para kohës së blerjeve. Ekipet e etiketuara si burra do të mbledhin 1600 deri në fund të ushtrimit, ekipi i etiketuara si grua-8000 dhe gruaja shtatzënë – 6000. Grupet e etiketuara si burrë do të jenë të parët që do të blejnë. Çdo grup duhet të blejë një mjet transporti & një ushqim që do përfaqësojë furnizimin ushqimor vjetor, me paratë e fituara.

Kujdes, asnjë lekë nuk duhet të shpërdorohet apo t'u jepet ekipeve të tjera, kështu që secili grup duhet të shpenzojë sa më shumë para të jetë e mundur. Si përfundim, grupet e etiketuara si burra do të blejnë mjetet më të shtrenjta të transportit (çmim:10000) dhe ushqimet më të shtrenjta (çmim:6000), ndërsa grupet e etiketuara si gra do të blejnë vetëm mjetet më të lira të transportit (çmim:4000) dhe ushqimet më të lira (çmim:2000).

Vlerësimi

Filloni duke pyetur pjesëmarrësit rreth **ndjesive** të tyre të para rreth aktivitetit:

- Si u ndjenë ata? Gishti i madh lart i përgjigjet “Më pëlqeu” dhe gishti i madh poshtë i përgjigjet “S’më pëlqeu”.
- Faktet: Çfarë ndodhi? Stimulohet pjesëmarrësit që të reflektojnë edhe njëherë se çfarë bënë në të gjithë aktivitetin.

Drejtjuni pyetje udhëzuese: Cili i përfundoi të 4 detyrat (1 ekip nuk e bëri, pasi nuk mund të krijonin dot kërcimin). Sa lekë arritët të mbledhni? Çfarë mund të blini me lekët e mbledhura? Pyesni ekipet që blenë gjërat më të lira se përse nuk mund të blinin të shtrenjtat. Pse ata kanë më pak lekë? Nëse të gjitha grupet kryenin të njëjtën detyrë, përse disa fitonin më pak para?

Ndajini ata në 2 grupe, emigrantët në 1 grup dhe pjesa tjetër në 1 grup (për 1 komunikim më të lehtë. 1 trajner duhet të jetë në çdo ekip për të drejtuar bisedimin). Pjesëmarrësit kanë 4 minuta kohë të dallojnë cilat janë dallimet ndërmjet 2 grupeve. Pasi pjesëmarrësit të zbulojnë që dallimi qëndron te ngjyra e etiketës, trajnerët duhet t'u kërkojnë të gjejnë se çfarë përfaqëson secila ngjyrë. Kur koha të përfundojë të gjitha grupet duhet të mbledhen për të diskutuar konkluzionet që arritën të nxjerrin në grupet e tyre.

Trajnerët duhet të sigurohen se të gjithë pjesëmarrësit e kuptuan se:

- 1 ngjyrë përfaqësonte burrat dhe tjetra gratë
 - ekipi me një numër në rreth përfaqësonte një grua shtatzënë
 - ekipet e etiketuara si gra fituan më pak para se burrat për të njëjtën punë të bërë
 - ekipi me gruan shtatzënë nuk kishte mundësinë të bënte një punë
 - ekipet e etiketuara gra janë trajtuar në mënyrë diferencuese nga ata të etiketuara burra
1. **Ndjesitë** – Si u ndjetë përgjatë aktivitetit? Trajnerët duhet të pyesin dhe të inkurajojnë pjesëmarrësit të shprehin ndjesitë e tyre, veçanërisht ata të ekipit të grave, për të parë ndryshimin ndërmjet ndjesive të ekipit të “burrave” dhe “grave”. Pjesëmarrësit duhet të kuptojnë se është e padrejtë fitimi i një page më të ulët për të njëjtën punë, vetëm për shkak të gjinisë.
 2. **Si e lidhni situatën me vendin (qyteti, shteti etj.) tuaj?** Trajnerët duhet të inkurajojnë pjesëmarrësit të diskutojnë situatën e tregut të punës në vendet e tyre, të gjejnë të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet tyre.

3. **Çfarë mësuat?** Trajnerët duhet të inkurajojnë pjesëmarrësit të realizojnë vetë rezultatet e të nxënit duke u drejtuar pyetje. Rezultatet e të nxënit duhet të jenë:
- Ndërgjegjësimi mbi pabarazinë gjinore dhe diskriminimin në tregun e punës
 - Trajtim dhe pritshmëri të ndryshme për burrat dhe gratë në vendin e punës
 - Përmirësimi i aftësive bashkëpunuese gjatë kryerjes së detyrave së bashku
 - Përmirësimi i kreativitetit dhe aftësive në logjikën dhe mendimin kritik
 - të tjera, në varësi të detyrave të zgjedhura
4. **E ardhmja** – Si do t’i aplikoni këto që mësuat në jetë? Trajnerët duhet të stimulojnë imagjinatën dhe memorien e pjesëmarrësve, duke i bërë ata të mendojnë për jetën e tyre të përditshme kur përballen me situata të pabarazisë gjinore dhe të gjejnë një zgjidhje që mund të ndihmojë në kalimin e problemit të pabarazisë gjinore. P.sh., Imagjinoni sikur keni një kompani, si do të sillleshit me punëmarrësit tuaj?

Pica e Vlerësimit

Në fund, pyetini pjesëmarrësit mbi vlerësimin e workshop-it duke përdorur instrumentin e “picës së vlerësimit”. Çdo pjesëmarrës duhet të shënojë një pikë ose shenjë në çdo fushë, afër qendrës nëse e kanë pëlqyer dhe larg nëse nuk e kanë pëlqyer. Pica duhet të përmbajë të gjitha punët që pjesëmarrësit kanë bërë, por edhe pjesë rreth trajnerëve, stimulusve dhe nëse workshop-i ishte **ARGËTUES**.

Këshilla për trajnuesit

- 1 nga trajnerët duhet të jetë përgjegjës për kohën.
- Dakordësoni për disa rregulla që mund të lehtësojnë diskutimet dhe të mbajnë vëmendjen e grupit (p.sh., nëse dikush do të flasë le të ngrejë dorën ndërkohë që pjesa tjetër është qetësi).
- Sigurohuni që të jepni sasinë e duhur të parave çdo ekipi.
- Bëni kujdes me gjuhën për të shmangur keqkuptimet.
- Krijoni një histori dhe drejtoni të gjithë aktivitetin në atmosferën e tregimit tuaj, për të ruajtur rrjedhën e punës dhe vëmendjen e pjesëmarrësve.